

**POLITIKA E INTEGRITETIT TË GJYKATËS SUPREME
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Prill, 2023

Organet shtetërore dhe institucionet e sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke u nisur nga angazhimet për sigurimin e respektimit të kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, integritetit profesional, transparencës dhe mbrojtjen për të drejtat dhe liritë e njeriut, miratuan si vijon:

POLITIKA E INTEGRITETIT

Organet shtetërore dhe institucionet e sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut e pranojnë integritetin si bazë e menaxhimit të mirë dhe përgjigjes strategjike të qëndrueshme të korrupsionit. Integriteti është me rëndësi thelbësore për prosperitetin ekonomik, social dhe shoqëror.

Me nocionin “Integritet” nënkuptohet kryerje të ligjshme, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente të punëve me të cilat personat zyrtarë e ruajnë autoritetin e tyre dhe autoritetin e institucionit në të cilin janë persona përgjegjës, përkatësisht të punësuar, i eliminojnë rreziqet dhe i mënjanojnë dyshimet në mundësinë nga paraqitja dhe zhvillimi i korrupsionit dhe me atë sigurojnë besimin e qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike.

Përforcimi dhe ngritja e integritetit është një mision i përbashkët dhe përgjegjësi e të gjitha institucioneve në sistemin e të gjitha niveleve të pushtetit.

Duke pranuar politikën e integritetit, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut merr përsipër për:

- (1) vendosjen e një sistemi të integritetit në institucionet,
- (2) zbatimin dhe mbështetjen e sistemit të integritetit dhe
- (3) ndjekjen dhe njoftimin për zbatimin e sistemit të integritetit.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut i njoftoi me politikën e saj të integritetit edhe anëtarët e sektorit privat, shoqërisë civile dhe qytetarët duke kërkuar nga ata, si partnerë në procesin, që t'i respektojnë vlerat e vendosura dhe standardet në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe institucionet e sektorit publik.

Vendosja e një sistemi të integritetit

Sistemi i integritetit është vendosur në mënyrë që tu mundësojë organeve shtetërore dhe institucioneve të sektorit publik të punojnë dhe të kryejnë kompetencat e tyre duke respektuar ligjet dhe në pajtim me standardet më të larta etike. Sistemi i integritetit bazohet në elementet në vijim të cilat paraqesin standarde të veçanta të integritetit:

- Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesave;

- Respektimin e kodit etik i cili është i rëndësishëm për pozitën e personit zyrtar;
- Menaxhimi me resurset njerëzore në bazë të sistemit të meritave dhe kualifikimit;
- Menaxhimi me dedikim, racional dhe efikas i resurseve publike;
- Transparenca dhe qasja në informacionet me karakter publik;
- Denoncimi i mbrojtur nga sinjalizuesit dhe
- Menaxhimi me cilësinë

Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesave

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të punësuarit e saj obligohen që në punën e tyre t'i japin prioritet interesit publik mbi atij privat dhe se do të nxisin dhe zhvillojnë kulturë organizuese që nuk toleron konflikt të interesave dhe në të cilën përgjegjësia individuale dhe shembulli personal bazohet në menaxhimin e mirë.

Për të mundësuar menaxhimin efikas me konfliktin e interesave në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut realizohet procedurë për identifikimin e qartë dhe deklarimin e interesave personale, përcaktohen rregulla për pritjet nga personat zyrtarë kur ekziston rreziku nga konflikti i interesave, sigurohet transparenca në procesin e zgjedhjes së situatave në të cilat paraqitet konflikt i interesave dhe zhvillohen mekanizma për ndjekjen e zbatimit të rregullave për parandalimin e konfliktit të interesave.

Respektimi i Kodit të etikës i cili është relevant për pozitën e personit zyrtar

Personat zyrtar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të detyruar që ta respektojnë Kodin e etikës të institucionit në të cilin punojnë, qëllimi i të cilave është të promovohet profesionalizmi, mbrojtja e interesit publik, llogaridhënia, përgjegjësia, paanshmëria, neutraliteti politik dhe jo diskriminues.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut zhvillon mekanizma të cilat mundësojnë në mënyrë të vazhdueshme të ndiqet respektimi i Kodit të etikës nga personat zyrtarë. Për fushat që janë shumë të ndjeshme ndaj korrupsionit, siç janë prokurimet publike, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton edhe kode të veçanta për procedim.

Menaxhimi me resurset njerëzore në bazë të një sistemi të meritave dhe kualifikimeve

Integriteti promovohet si një pjesë e menaxhimit me resurset njerëzore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Punësimet janë transparente nëpërmjet shpalljeve publike, me kritere të përcaktuara që më parë dhe me politika të zhvilluara që mundësojnë punësime dhe avancime në bazë të meritave dhe kualifikimeve dhe pamundësojnë ndikime partiake, nepotizëm dhe kronizëm (miqësi).

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë identifikuar pozitat e punës të cilat janë veçanërisht të cenushme nga korrupsioni dhe për to janë parashikuar detyrime të veçanta në lidhje me mbrojtjen e integritetit. Duhet që vazhdimisht të respektohen papajtueshmëritë, ndalimet dhe kufizimet e karakterizuara për punën në sektorin publik.

Menaxhimi me dedikim, racional dhe efikas me resurset njerëzore

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut demonstroi çiltërsi, llogaridhënie dhe përfshirjen në përcaktimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të udhëhequra nga qëllimet për të kënaqur interesin publik dhe vazhdimisht të përmirësojnë shërbimet për qytetarët. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut merr përsipër që kontratat për prokurime publike, partneritetet publiko-private, dhënie me koncesion të resurseve shtetërore, dhënie me qira dhe shitje të pronës dhe tokës shtetërore etj. do t'i lidh përmes procedurave transparente që mundësojnë trajtim të barabartë dhe konkurrencë të pjesëmarrësve të interesuar.

Transparenca dhe qasja në informacionet me karakter publik

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut u siguron informacione të vërteta, përkatëse, në kohë dhe të plota qytetarëve dhe personave juridik, pastaj duke respektuar të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut synon për një nivel të lartë të transparencës aktive, respektivisht publikojnë sa të jetë e mundshme më tepër informacione në ueb – faqen e tyre dhe demonstroi gatishmëri për kontroll dhe mbikëqyrje publike për punën e saj.

Personat zyrtar nuk guxojnë t'i shfrytëzojnë informacionet me të cilat disponojnë në kryerjen e funksioneve, autorizimeve publike dhe detyrave zyrtare për realizimin e dorisë ose përparësisë për vete ose për dikë tjetër.

Denoncimi i mbrojtur nga sinjalizuesit

Mundësia e sinjalizuesve për të denoncuar veprim të palejuar ose të paligjshëm duke mos pasur frikë nga pasojat, paraqet një nga shtyllat për parandalimin e suksesshëm, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e veprimeve të këtilla me të cilat rrezikohet puna e institucionit.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton procedura për denoncim të mbrojtur dhe ka një person të autorizuar për pranimin e denoncimeve nga sinjalizuesit. Me procedurën për denoncim të mbrojtur dhe me personin e autorizuar njoftohen të gjithë palët e prekur.

Menaxhimi me cilësinë

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vendos sistem të punës përmes të cilit avancohet vazhdimisht puna dhe proceset, zvogëlohen rreziqet dhe shpenzimet dhe përmirësohet motivimi i të punësuarve dhe ndiqen rezultatet totale të punës.

Avancimi i realizimit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve bëhet përmes planifikimit të përgjegjshëm, menaxhimit dhe realizimit të proceseve dhe promovimit të një kulture të shkëlqyer të administratës publike, në pajtim me standardin ndërkombëtar ISO 9001, Kornizën e përbashkët për vlerësim – CAF dhe standarde tjera për cilësinë e sektorit publik.

Realizimi dhe mbështetja e sistemit të integritetit

Për të mundësuar realizimin efikas të sistemit të integritetit, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është përkushtuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e të gjithë personave zyrtar në procesin e plotësimit të detyrave që rezultojnë nga standardet e integritetit për kryerjen e detyrave të punës në mënyrë ligjore, të pavarur, të paanshme, etike, me përgjegjësi dhe transparente.

Strukturat udhëheqëse në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë përgjegjës për vendosjen dhe realizimin e sistemit të integritetit, si dhe për promovimin e tyre nëpërmjet shembullit të tyre personal dhe marrjen e masave për pranimin kolektiv të politikës së integritetit dhe përmbajtja e të njëjtës nga të punësuarit.

Ndërtimi i kapaciteteve zhvillohet përmes edukimit të rregullt të punësuarve për zbatimin përkatës të standardeve të integritetit nëpërmjet trajnimeve, si dhe nëpërmjet mundësimin të këshillimeve për të gjitha dilemat të cilat mund të paraqiten te personat zyrtar në punën e përditshme.

Për sigurimin e realizimit efikas të sistemit të integritetit Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron një person për integritet. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut i identifikon rreziqet nga korrupsioni dhe të njëjtat rregullisht i ndjek dhe i vlerëson. Në mënyrë përkatëse ndërmerren edhe masa për tejkalimin e rreziqeve të cilat e rrezikojnë integritetin e institucionit.

Ndjekja dhe njoftimi për zbatimin e sistemit të integritetit

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut mundëson sistem dyshkallësh të ndjekjes së zbatimit të sistemit të integritetit, në nivel të vet institucionit, dhe nga ana e institucionit kompetent, Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Qëllimi i ndjekjes së sistemit të integritetit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është që të përcaktohet efikasiteti i politikave të zbatuara dhe

procedurave që mundësojnë zbatimin e vazhdueshëm të standardeve të integritetit, si dhe matjen e rezultateve nga masat e zbatuara për zvogëlimin e rreziqeve nga korrupsioni.

Procesin për ndjekjen dhe njoftimin e zbatimit të sistemit të integritetit e koordinon personi i integritetit. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut realizon edhe kontrole të brendshme për kontrollimin e realizimit të standardeve të integritetit përmes përfshirjes së revizionit të brendshëm.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut detyrohet për bashkëpunim me KSHPK duke i mundësuar të ndjek realizimin e sistemit të integritetit.

Për atë qëllim, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut detyrohet që në mënyrë të saktë, rregullisht dhe në kohë të informojë KSHPK për të gjitha aktivitetet e ndërmarra në drejtim të zbatimit të sistemit të integritetit, si dhe për realizimin e drejtimeve të pranuar, rekomandimeve dhe sugjerimeve nga ana e KSHPK sa i përket përforcimit të integritetit në institucionet.

**KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Besa Ademi